

-
VENDIM

(Për sigurimin e padisë)

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me trup gjykues

të përbërë nga:

Gjyqtar: Fatmir NDREU

asistuar nga sekretarja gjyqësore **Amantia Zisi**, sot, më datë 17.10.2025, në Tiranë, në Dhomë Këshillimi, mori në shqyrtim çështjen civile me nr. **996** regj. them., e regjistruar në datë 15.10.2025, që i përket:

KËRKUES: **Shoqëria “2A Group”** (Degë e shoqërisë së *****), me NUIS M12211048J, përfaqësues ligjor Valon Ademi, me adresë të Zyrës Qendrore të Degës së Përfaqësimit në Shqipëri: Rruga “Faik Konica”, pallati 6, shkalla 5, zyra 7, Tiranë 1010.

PALE E INTERESUAR: **Shoqëria “Vlora International Airport – VIA” SH.P.K.**, me NUIS M11809002I, me adresë: Rruga “29 Nëntori” pall. Constech, objekti 2, kati 1, ZK 2679, Nr. Pasurie 440/384, Njësia Administrative 7, Tiranë.

OBJEKTI: 1. Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke pezulluar marrjen e çdo vendimi në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë “Vlora International Airport-VIA” SH.P.K. të njoftuar për tu mbajtur me datën 20.10.2025 sipas atij rendi dite, deri në zgjidhjen e çështjes me një vendim të formës së prerë.

2. Pezullimin e të drejtës së votës të ortakut të shumicës Shoqëria “Mabco Construction SA” deri në regjistrimin e kontratës së shitjes së kuotave të datës 03.04.2025 me objekt transferimin e kontratës së shitjes së kuotave të datës 03.04.2025 për transferimin e 49% të kuotave të kapitalit të shoqërisë VIA ***** tek blerësi 2A Group sh.p.k.

BAZA LIGJORE: Neni 42 i Kushtetutës. Nenet 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, Ligji nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Ligji nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”.

Gjykata në dt. 17.10.2025,

V Ë R E N:

-

se, subjekti Shoqëria "2A Group" (Degë e shoqërisë së *****) ka paraqitur për gjykim, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, kërkesën me objekt siç është cituar në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Kërkuesi parashtrohet se:

1. Shoqëria "Vlora Internacional Aeroport-VIA" SH.P.K., me NUIS M11809002I, është një shoqëri tregtare e regjistruar në QKB me datën 17.05.2021, me objekt të veprimtarisë së saj "Zbatim i Kontratës së së Koncesionit nënshkruar ndërmjet ortakëve të shoqërisë (Bashkim i Operatorëve Ekonomikë të shpallur fitues në procedurën e tenderit) dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës, që në mënyrë të veçantë ndër të tjera do të konsistojë në projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA).
2. Në zbatim të Kontratës Koncesionare të dt. 15.06.2021, të lidhur mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës (MIE) dhe Shoqërisë "Vlora Internacional Aeroport-VIA" sh.p.k., në procedurat e tenderimit (për të cilën u shpallën fitues) ky Bashkimi i Opetorëve Ekonomikë të Shoqërive përbëhet nga shoqëritë: "2A Group" sh.p.k., "Mabco Construction" dhe Shoqëria "YDA INSAAT SANAYI VE TICARET". Kjo e fundit, më datën 08.09.2022, me kontratën noteriale me nr. 5949 rep. dhe 2120 kol., i shet 40% të kuotave të saj në Shoqërinë "Vlora Internacional Airopor-VIA" SH.P.K. shoqërisë "Mabco Construction SA". Ky veprim është pasqyruar në Ekstraktin Historik të shoqërisë VIA me datën 29.12.2022.
3. Në vijimësi, gjatë kohës që projekti po zbatohet nga Shoqëria "Vlora Internacional Aeroport-VIA" sh.p.k., dy shoqëritë ortakë të saj lidhin një marrëveshje tjetër për tjetërsimin e kuotave e cila është shprehur me "Parakontratën për shitblerjen e kuotës së aksioneve" të lidhur mes Shoqërisë "Mabco Contructions SA" dhe Shoqërisë "2A Group" sh.p.k. me objekt shitjen e kuotave. Pas kësaj parakontrate për këtë qëllim është lidhur një "Marrëveshje Shitje Blerje" e datës 19.06.2024 mes këtyre shoqërive, me objekt shitjen e 47% të kuotave të Mabco te Shoqëria "2A Group". Kjo Marrëveshje është nënshkruar për Shoqërinë "2A Group" nga përfaqësuesi ligjor i saj Valon Ademi dhe për Shoqërinë "Mabco Contruction SA" nga Valon Lluka, i autorizuar për kryerjen e këtij veprimi me prokurën e posaçme me numër 4725 rep., 1779 kol., dt 20.07.2023.
4. Theksojmë për këtë tjetërsim të 47% të kuotave që Shoqëria "Mabco Contruction SA" kishte te VIA ka marrë vendim edhe Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë "Mabco Contruction SA" në mbledhjen e datës 20.07.2023. Bazuar në këto akte, Shoqëria "2A Group" ka paguar vlerën e blerjes së 47% të kuotave, duke kaluar në llogari të Shoqërisë "Mabco Contructions SA" 4700.00 euro, përmes transaksionit bankar me numër 68100563540004.
5. Për këtë qëllim, palët kanë lidhur edhe një kontratë noteriale për shitblerjen e kuotave dhe konkretisht kontratën noteriale me numër 2437 rep., 941 kol., dt. 03.04.2025. Përmes kësaj kontrate, Shoqëria "Mabco Construction SA" i shet Shoqërisë "2A Group" sh.p.k. 47% të kapitalit të saj në Shoqërinë "Vlora International Airport-VIA" sh.p.k. për vlerën 4700.00 euro (neni 3 i kontratës së shitblerjes). Në këtë kontratë dhe përkatësisht në nenin 4 të saj, palët janë shprehur si më poshtë: "Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje, palët deklarojnë dhe bien dakort se kjo Marrëveshje konsiderohet e ekzekutuar plotësisht, pavarësisht datës së regjistrimit të kuotës në regjistrin tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit. 4.1 Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje Kuota konsiderohet e transferuar nga Shitësi te Blerësi së bashku me të gjitha të drejtat dhe detyrimet përkatëse, përfshirë të drejtën e përfitimeve, të drejtën e votës dhe çdo të drejtë tjetër që rrjedh nga pronësia mbi kuotën sipas legjislacionit të zbatueshëm...". Mbështetur në këtë kontratë rezulton qartë se, pas datës

03.04.2025 në Shoqërinë “Vlora International Airport-VIA” sh.p.k., zotërimi i kuotave ishte i ndarë: 49% Shoqëria “2A Group” sh.p.k. dhe 51% Shoqëria “Mabco Constructions SA”, gjendje e cila ekziston edhe aktualisht.

6. Theksojmë faktin se, bazuar në këtë kontratë dhe konkretisht nenin 2 të saj, parashikohet detyrimi i Shoqërisë “Mabco Construction SA” që të ofrojë të gjithë bashkëpunimin dhe asistencën e nevojshme që transferimi i titullit dhe pronësisë së kuotës të regjistrohet në regjistrin e kuotave të shoqërisë, në dobi të blerësit... Me qëllim regjistrimin e kuotës nga blerësi në regjistrin tregtar të mbajtur nga QKB, shitësi do të sigurojë të gjithë bashkëpunimin e nevojshëm që blerësi të përmbushë një detyrim të tillë në thirrjen e parë të blerësit, i cili gjithashtu përfshin ose mund të përfshijë dhënien e deklaratave të çdo lloji ose lidhjen e ndonjë shtese të kësaj marrëveshje ose ndërmarrjen e ndonjë veprimi tjetër të kërkuar për transferimin e vlefshëm të kuotës, siç përcaktohet në këtë marrëveshje.

7. Theksojmë se kjo kontratë shitblerje e kuotave, ndryshe nga kontrata e datës 08.09.2022, nuk është pasqyruar në Ekstraktin Historik të Shoqërisë “Vlora International Airport-VIA” sh.p.k. dhe kjo për shkak të një marrëveshje mes palëve. Pavarësisht mospublikimit të kësaj kontrate në QKB, mbështetur edhe në parashikimet e kontratës së shitblerjes së sipërcituar është e qartë që pasqyrimi i saj në regjistrin tregtar nuk sjell pasoja për vlefshmërinë e kontratës. Kjo për shkak se kalimi i kuotave nga Shoqëria “Mabco Constructions” te Shoqëria “2A Group” është një veprim që ka sjellë efektet me nënshkrimin e kontratës dhe kalimin e shumës së blerjes/shitjes, provuar ky i fundit me transaksionin bankar të datës 12.07.2024, me numër transaksioni 68100563540004.

8. Në lidhje me këtë, theksojmë se në nenin 79 të Kodit Civil është parashikuar shprehimisht: “Veprimi juridik është shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile”. Në analizë të kësaj dispozite, që një veprim juridik të jetë i vlefshëm duhet që të plotësohen këto kushte: Palët që kryejnë veprimin juridik duhet të kenë zotësinë për të vepruar; Vullneti i brendshëm i palëve në një veprim juridik duhet të përputhet me shfaqjen e tij të jashtme; Veprimi juridik duhet të realizohet në formën e kërkuar nga ligji. Pra njafton plotësimi i elementeve të mësipërme për të bërë të vlefshëm veprimin juridik.

9. Veprimi juridik nuk është gjë tjetër veçse shfaqja e ligjshme dhe e lirë e vullnetit të personit fizik ose juridik. Shfaqja e vullnetit është e lidhur ngushtë me dëshirën e personit për të kryer veprimin juridik. Shfaqja e vullnetit synon në ardhjen e pasojave të caktuara, në lindjen, ndryshimin ose shuarjen e të drejtave ose detyrimeve civile. Është mëse e domosdoshme që personi fizik ose juridik jo vetëm të (1) shfaqë vullnetin e tij të lirë, por edhe (i) ky vullnet të jetë i ligjshëm. Sa më sipër është një dukuri e cila perceptohet nga sjellja e jashtme e personit fizik që kryen veprimin juridik dhe kjo shfaqje vullneti duhet të bëhet në mënyrë të ligjshme ndryshe nuk është e plotë. Në rastin konkret, përmes hartimit dhe nënshkrimit të tre kontratave mes palëve, me objekt tjetërsimin e kuotave, si dhe marrjes së vendimeve me këtë objekt në Asamblenë e Ortakëve të secilës shoqëri, pasqyrohet qartësisht vullneti i tyre i shprehur në këto akte. Ky vullnet lidhet me tjetërsimin e këtyre kuotave, ku kalimi i pronësisë sjell efekt që në momentin e nënshkrimit të saj nga palët, pavarësisht nëse kjo kontratë është regjistruar apo jo QKB.

10. Në nenin 164 të Kodit Civil parashikohet “Pronësia fitohet me kontratë pa qenë e nevojshme të bëhet dorëzimi i sendeve. Për sendet që përcaktohen në numër, në peshë ose me masë duhet të bëhet dhe dorëzimi i tyre”. (Fitimi i pronësisë në mënyrë të prejardhur). Kontrata e shitblerjes përmendur më sipër nuk është gjë tjetër veçse një veprim juridik i dyanshëm i realizuar mes palëve. Në nenin 659 të Kodit Civil parashikohet që: “Kontrata nuk është gjë tjetër veçse një veprim juridik, me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike”.

11. Kontrata e shitblerjes, si veprim juridik i dyanshëm, plotëson kushtet për vlefshmërinë e saj edhe në rast se nuk regjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme, pra edhe në këtë rast ajo është plotësisht e vlefshme mes palëve që e kanë realizuar atë. Është kontrata e shitblerjes ajo që transferon mes palëve pronësinë e sendit të paluajtshëm, krijon të drejta reale mbi sendin dhe legjitimon pronarin të kërkojë dhe mbrojë këto të drejta.

12. Si regjim imponues transkriptimi ose regjistrimi karakterizohet nga dy parime bazë:

(1) *Parimi i deklarimit* që nënkupton se regjistrimi ka vlerë deklarative, njohës dhe nuk ka vlerë krijues. Regjistrimi nuk ka vlerë krijues, në kuptimin që regjistrimi nuk është një element i perfeksionimit të kontratës dhe as kusht për

fitimin e të drejtës mbi pasurinë e paluajtshme. Regjistrimi nuk eliminon nulitetin apo pavlefshmërinë e kontratës, si veprim juridik i regjistruar në regjistrin publik.

Regjistrimi nuk siguron vlefshmërinë dhe efikasitetin e titullit të pronësisë. Ky sistem siguron vetëm faktin që shitësi figuron si pronar në bazë të të dhënave të regjistrimit, por nuk garanton në mënyrë absolute vlefshmërinë e të drejtës së pronarit dhe se ky i fundit është pronar i ligjshëm. Kjo pasi sistemi i regjistrimit nuk krijon të drejta, por është një sistem i publikimit deklarativ.

(ii) *Parimi i prioritetit në kohë*, që nënkupton se akti që regjistrohet i pari në regjistrin publik ka vlerë mbizotëruese.

Pikërisht, marrja e saktë e informacionit nëpërmjet publikimit krijon siguri në qarkullimin e pasurive, duke mundësuar që përfituesi i të drejtave mbi sendin të jetë i garantuar për sendin që blen dhe të drejtat reale përkatëse.

13. Shpjegojmë se, gjatë zbatimit të kësaj kontrate kanë filluar të shfaqen probleme, që lidhen me marrjen nga Shoqëria “Mabco Constructions SA” të vendimeve pa marrë miratimin e ortakut tjetër, duke i publikuar ato në faqen e QKB si vendime të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të VIA-s. Kështu, më datën 26.05.2025 në faqen e QKB të Shoqërisë VIA është publikuar vendimi për ndryshimin e adresës së shoqërisë, nga ajo e cila rezultonte në Statutin e Themelimit të saj, Rruga “Donike Kastrioti”, ndërtesa 4, Kodi Postar 1119, Njësia Bashkiake nr. 5, 1000 Tiranë, në Rruga “29 Nentori” pall. Constech, objekti 2, kati 1, ZK 2679, Nr. Pasurie 440/384, Njësia Administrative 7 Tiranë). Ritheksojmë se ky vendim nuk është një vendim i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë VIA, pasi mbledhja e Asamblesë së Ortakëve nuk është thirrur asnjëherë për këtë qëllim.

14. Më datën 22.05.2025, përfaqësuesit e Shoqërisë “2A Group” janë vënë në dijeni të një publikimi tjetër të paligjshëm të kryer në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në faqen që i përket Shoqërisë “Vlora International Airport-VIA” sh.p.k., të një vendimi që nuk i përket mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve të kësaj shoqërie. Ky publikim është me numer çështje CN-516234-08-25, ku në lidhje me arsyet e hapjes citohet: *Depozitim i vendimit datë 19.08.2025 për kufizimin e çdo transferimi pronësie të kuotave të zotëruara nga “Mabco Construction SA” në kapitalin themeltar të “Vlora Internacional Airoport-VIA” sh.p.k. deri në një vendimarrje të dytë.* Në dokumentet e depozituara për publikimin e këtij njoftimi është vendimi i Asamblesë së Përgjithshme.

15. Duke qenë se, sikurse e cituam edhe me lart, Shoqëria “2A Group” sh.p.k. është ortak e Shoqërisë “Vlora Internacional Aeroport-VIA” sh.p.k. dhe ndodhur në kushtet që ajo nuk kishte asnjë informacion në lidhje me një vendim të tillë të publikuar dhe për me tepër nuk kishte marrë pjesë në ndonjë mbledhje të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë “VIA”, në faqen e së cilës u publikua ky vendim, përfaqësuesit e saj janë interesuar në lidhje me rrethanat konkrete të tij, fillimisht pranë ish-administratorit të VIA-s, Z. Valon Lluka. Ky i fundit ka bërë të ditur faktin se publikimi në faqen zyrtare të Shoqërisë “VIA” të vendimit të datës 19.08.2025, me objekt kufizimin e çdo transferimi pronësie të kuotave të Shoqërisë “Mabco Construction SA” në kapitalin themeltar të Shoqërisë “Vlora Internacional Airoport-VIA” sh.p.k., nuk është bërë nga ana e tij, në cilësinë e administratorit të kësaj të fundit, por ky publikim është bërë nga Z. Nelson Çela, i cili, nga ana tjetër, është Përfaqësues Ligjor i Shoqërisë “Mabco Construction SA”, pra përfaqësues i një prej ortakëve të shoqërisë në faqen e së cilës u publikua ky vendim. Theksojmë se z. Nelson Çela nuk ka asnjë funksion dhe as cilësi në Shoqërinë “Vlora International Airport-VIA” sh.p.k. duke shpërdoruar kompetencat të cilat nuk i ka të njohura as në ligj dhe as në statut.

16. Në lidhje me vendimin në fjalë, të publikuar në faqen e QKB të Shoqërisë “Vlora Internacional Aeroport-VIA” sh.p.k., shpjegojmë se ai është një vendim i Shoqërisë “Mabco Construction SA”, në përmbajtjen e të cilit rezulton si më poshtë: *Me dt. 21.08.2025 Shoqëria “Mabco Construction SA”...ortake në Shoqërinë “Vlora Internacional Airoport-VIA” sh.p.k. duke qenë se konsideroi çështjet e trajtuara në këtë vendim në përputhje me statutin e VIA dhe ligjin për shoqëritë tregtare VENDOSI: Kufizimin e çdo transferimi pronësie (të kaluar, të tashëm apo të ardhshëm) të kuotave të zotëruara nga Mabco në kapitalin e VIA, deri në një vendimarrje të dytë dhe regjistrimin e tyre në QKB. Regjistrimin e këtij vendimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit.*

17. Ndodhur në këto kushte, në cilësinë e përfaqësuesit të ortakut i cili zotëron 49% të aksioneve të Shoqërisë “Vlora Internacional Aeroport-VIA” SH.P.K. dhe subjektit i cili realisht është dëmtuar nga ky publikim i paligjshëm, përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë “2A Group” Z. Valon Ademi i është drejtuar me datën 25.08.2026 Shoqërisë “Vlora Internacional Airoport” sh.p.k. dhe konkretisht administratorit të saj në atë kohë Valon Lluka, duke i kërkuar marrjen e masave për regjistrimin në OKB të kalimit të 47% të kuotave nga Shoqëria “Mabco Construction SA” te Shoqëria “2A Group” sh.p.k., duke u pasqyruar ky ndryshim në ekstraktin historik aktual të Shoqërisë VIA. Pavarësisht këtyre kërtimeve, ish-administratori i shoqërisë Valon Lluka nuk ka kryer veprime për të pasqyruar në QKB dhe në ekstraktin historik të shoqërisë VIA gjendjen faktike të zotërimit të kuotave mes ortakëve të saj, bazuar kjo në kontratën e shitblerjes kontratën noteriale me numer 2437 rep., 941 kol., dt. 03.04.2025.

18. Ndodhur në këto kushte, përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë “2A Group” Z. Valon Ademi i është drejtuar me kërkesë edhe Shoqërisë “Mabco Contruction SA” me kërkesë, duke kërkuar thirrjen e mbledhjes së jashtëzakonshme të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve në datën 01.09.2025, me rend dite:

- *Diskutimi dhe miratimi i rritjes së kapitalit të shoqërisë nëpërmjet konvertimit në kapital të detyrimit financiar të VIA ndaj Shoqërisë “2A Group” në vlerën 15,000,000.00 (pesëmbëdhjetë milion) euro, e cila përfaqëson vetëm një pjesë të detyrimeve të krijuara nga punime të kryera dhe faturuara.*

- *Vendosja e procedurave të emetimit të kuotave të reja në favor të Shoqërisë “2A Group” duke reflektuar përqindjen e re të kapitalit në QKB.*

- *Çështje të tjera që lidhen me administrimin e shoqërisë.*

19. Theksojmë se, paraqitja e këtyre kërkesave Shoqërive VIA dhe “Mabco Contruction SA” nga përfaqësuesi i Shoqërisë “2A Group” ka për bazë jo vetëm faktin se kjo e fundit është zotëruese *de facto* e 49% e kuotave në Shoqërinë VIA, por bazuar edhe në vlerën e investimit që shoqëria “2A Group” ka bërë në realizimin e objektit të kontratës koncesionare, që deri në këtë moment shkon në vlerën 22,850,156.38 euro.

20. Në lidhje me kërkesën për thirrjen e mbledhjes së jashtëzakonshme të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë VIA, administratori i Shoqërisë “Mabco Contruction SA” ka kthyer përgjigje me shkresën e datës 04.09.2025, ku i ka bërë me dije Shoqërisë “2A Group” se ai nuk mund të marrë pjesë në mbledhjen e caktuar dhe kjo mbledhje të caktohet në një datë të mëvonshme. Gjithashtu, theksojmë se Shoqëria “Mabco Contruction SA” jo vetëm që nuk ka pranuar të marrë pjesë në mbledhjen me rend dite të kërkuar nga Shoqëria “2A Group”, por edhe nuk ka kryer asnjë veprim për regjistrimin e kalimit të kuotave në favor të ortakut tjetër, detyrim të cilin ajo e kishte marrë përsipër në bazë të nenit 2 të Kontratës së Shitblerjes me nr. 2437 rep., 941 kol., dt. 03.04.2025, madje ka penguar regjistrimin në QKB të kalimit të këtyre kuotave për të cilat ajo kishte lidhur 3 akte të shitjes së tyre.

21. Shpjegoj se, gjatë kësaj kohe, Shoqëria “Mabco Contructions SA” ka kryer edhe një shkelje tjetër të Statutit të Shoqërisë VIA dhe të legjislacionit për shoqëritë tregtare, e cila konsiston në faktin se kjo shoqëri, përmes një njoftimi të pavlefshëm drejtuar Shoqërisë “2A Group”, i cili është bërë në kundërshtim me afatin për njoftimin e mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve, të përcaktuar në nenin 83 të ligjit 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, (pasi ky njoftim është bërë 5 ditë përpara mbledhjes) ka zhvilluar një mbledhje, ku ka shkarkuar administratorin e saj Z. Valon Lluka dhe ka emëruar në këtë detyrë Z. Mentor Hajdaraj, me të cilin është lidhur një Kontratë Shërbimi. Theksojmë se më datën 06.10.2025 edhe ky i fundit ka dhënë dorëheqjen nga ushtrimi i kësaj detyre dhe aktualisht shoqëria VIA nuk ka një administrator të saj.

22. Më datën 11.10.2025, Ortaku i Shoqërisë VIA, Shoqëria “Mabco Contruction SA”, përmes një procedure jo të rregullt (pasi njoftimin nuk e ka bërë në postën me shkrim të ortakut tjetër, siç kërkohet në nenin 14.3 të Statutit të Shoqërisë) ka njoftuar mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve me datën 20.10.2025, me rend dite:

- *Miratimin e statutit të ri të Shoqërisë VIA*

- *Emërimin e administratorit të ri*

- Emërimin e Drejtorit Teknik

Evidentohet fakti se, edhe pse ky ortak ishte në dijeni të kërkesave të paraqitura për zhvillimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të paraqitur nga Shoqëria “2A Group”, sipas rendit të ditës të sipërcituar, ky rend dite nuk ishte përfshirë në rendin e ditës të përcaktuar për t'u diskutuar në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të datës. Pra, qartazi Shoqëria “Mabco Construction SA” me veprimet e saj ka kryer disa shkelje:

- Nuk ka pranuar të marrë pjesë, duke penguar zhvillimin e mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve, për rendin e ditës së kërkuar nga Shoqëria “2A Group”, sipas kërkesës së kësaj të fundit të datës 01.09.2025.
- Ka caktuar një datë për zhvillimin e mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve, ku njoftimin për ortakun nuk e ka dërguar në formën e kërkuar nga ligji për shoqëritë tregtare dhe Statuti i Shoqërisë.
- Në këtë mbledhje të fundit nuk ka përfshirë në rend dite ato që ka kërkuar ortakë në njoftimin e datës 01.09.2025, por ka përfshirë disa çështje të tjera, të cilat, siç do t'i trajtojmë më poshtë, kanë si qëllim final përjashtimin e Shoqërisë “2A Group” nga VIA.

23. Në lidhje me këtë pretendim të fundit, shpjegojmë se nga Drafti i Statutit të ri, i cili është dërguar bashkalidhur me njoftimin për zhvillimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, konstatohen ndryshime thelbësore në raport me Statutin e mëparshëm të Shoqërisë VIA, ndryshime këto që cenojnë thellësisht interesat e Shoqërisë “2A Group”. Këto ndryshime shfaqen në disa drejtime:

- *Në përcaktimin e momentit të kalimit të kuotave, ku në nenin 2.05 është parashikuar se kalimi i kuotave lidhet me momentin e regjistrimit të këtij kalimi në QKB (në kundërshtim kjo me nenet 38 dhe 39 të Statutit në fuqi dhe me nenin 164 të K.Civil).*
- *Ky Draft Statut parashikon edhe të drejtën e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve (neni 5.01) për anulimin e kuotave, ku vendimi është parashikuar të merret me shumicë të thjeshtë dhe kjo vendimarrje është e vlefshme vetëm nëse miratohet nga ortakë që zotërojnë kuota që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e kapitalit të shoqërisë (pra praktikisht këtë të drejtë ia ka dhënë shoqërisë Mabco e cila në mënyrë faktike zotëron 51% të kuotave të shoqërisë VIA në çdo rast).*
- *Në shtojcën 1 të këtij Draft Statuti është përcaktuar se ndarja e kuotave mes ortakëve të Shoqërisë VIA është 98% Shoqëria “Mabco Construction SA” dhe 2% Shoqëria “2A Group”, fakt ky i pavërtetë, pasi nga aktet që cituam më lart (parakontratë, marrëveshje shit-blerje kuotave dhe kontrata noteriale) për shkak të tjetërsimit të kuotave nga Shoqëria “Mabco”, kjo e fundit nuk zotëron më 98%, por 51% të kuotave dhe po kështu Shoqëria “2A Group” nuk zotëron më 2%, por 49% të kuotave, gjë që pasqyron pronesinë reale mbi kuotën fituar kjo me akt noterial.*

24. Shpjegojmë se, këto veprime të paligjshme të Shoqërisë “Mabco Constructions SA” nuk përbëjnë veprimet e vetme të kryera në dëm të interesave të Shoqërisë VIA dhe ortakut tjetër të saj, Shoqërisë “2A Group”. Në fakt, këto veprime janë kryer në funksion të një qëllimi të vetëm që Shoqëria Mabco ka patur përpara kryerjes së tyre, që në thelb lidhet me tjetërsimin e vetë projektit për të cilin është lidhur Kontrata Koncesionare me MIE (Ministrinë e Energjitikës dhe Infrastrukturës) që është Aeroporti i Vlorës.

25. Në lidhje me këtë pretendim, shpjegojmë se Shoqëria “Mabco Construction SA”, në mënyrë të njëanshme, me marrë miratimin edhe të ortakut tjetër të VIA-s, që është Shoqëria “2A Group”, ka lidhur një kontratë kredie me një subjekt huadhënës të panjohur, përmes ndërmjetësimit të kësaj marrëveshje nga Delfos. Kjo kontratë kredie (e cila është e fshehtë për ortakun Shoqërinë “2A Group”), ka si objekt dhënien e një huaje në vlerën 100.000.000 euro dhe është marrë pa miratimin e mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve të VIA, me qëllim realizimin/financimin e projektit të VIA, duke lënë si garanci pikërisht projektin për të cilin është lidhur Kontrata Koncesionare.

26. Shpjegojmë se, kjo kontratë, edhe pse në dukje është një kontratë huaje, në fakt është një kontratë shitje e

projektit për të cilin është lidhur Kontrata Koncesionare shoqërisë të panjohur huadhënëse/kredidhënëse. Kjo për shkak se përmes kësaj kontrate, Shoqëria VIA jo vetëm që ngarkohet me pagimin e detyrimeve shtesë në lidhje me interesat bankare në mënyrë të pajustificuar (interesa këto shumë më të mëdha se ato që VIA kishte me BKT), por edhe bazuar në faktin se përmes kësaj kontrate një subjekti huadhënës të panjohur i jepen tagra të ndërhyrje në të gjitha politikat financiare të Shoqërisë VIA, përmes dhënies së të drejtës për t'u njoftuar për ndryshimin e statutit, ndryshimin e administratorit, ristrukturimin, deri në njoftimin e saj për informacionet konfidenciale që i dërgohen MIE. Pra përmes kësaj kontrate kredie, VIA dhe i gjithë projekti i Kontratës Koncesionare kalon në zotërimin absolut të kredidhënësit të panjohur. Shpjegoj se, këto të drejta që i janë dhënë këtij subjekti kredidhënës të panjohur, pa marrë miratimin jo vetëm të ortakut tjetër të VIA-s, po edhe pa marrë miratimin e vetë Koncesionarit (Ministria e Infrastrukturës së Energjitikës), e cila nuk i është njoftuar, janë në kundërshtim të hapur me Statutin e VIA-s, por edhe me Kontratën Koncesionare e datës 02.06.2021.

27. Bazuar në kushtet e shlyerjes së detyrimeve financiare që burojnë nga kjo kontratë kredie, Shoqëria VIA do të jetë në pamundësi të paguajë detyrimet e saj (për shkak të detyrimeve financiare të rënda në raport kjo me planin e biznesit të miratuar me nënshkrimin e Kontratës Koncesionare). Për këtë shkak ekziston mundësia potenciale që ky huadhënës i panjohur nga ortakut tjetër i VIA, nga Autoriteti Kontraktor (MIE) dhe nga banka e cila e ka financuar në fillim këtë projekt BKT, të marrë projektin e kontratës, pra Aeroportin e Vlorës. Pra, në thelb, ky projekt i është shitur një huadhënësi të panjohur nga Shoqëria “Mabco Construction SA”, duke përdorur artifica të ligjit edhe pse të paligjshme në mënyrën si janë ndërmarrë, por që vënë në rrezik deri sigurinë kombëtare për pasojat që mund të ketë në veprën që po ndërtohet dhe kush do të jetë përfituesi fundor i këtyre paligjshmërive që po realizohen.

28. Pra, shpjegojmë se ky “Facility Agreement”, ndonëse i paraqitur në formë të një marrëveshjeje huaje midis Shoqërisë “Mabco Constructions S.A.” dhe “Delphos Securities SARL”, në substancë nuk përmban karakteristikat e një huaje klasike bankare. Elementet kontraktore dhe struktura e saj tregojnë se objektivi real nuk është thjesht financimi i projektit, por marrja e kontrollit ekonomik dhe operacional mbi aeroportin përmes instrumenteve të borxhit. Karakteristikat e kësaj kontrate janë:

- **Karakter i formal:** Formalisht, kontrata nuk parashikon transferim kuotash ose ndryshim pronësie. Në panje të parë, aksionarët mbeten të njëjtët dhe dokumenti duket si një marrëveshje financimi. Kjo maskë formale është vendosur për ta paraqitur marrëveshjen si financim të zakonshëm dhe jo si ndryshim pronësie apo shitje.
- **Substanca reale:** Në substancë, huadhënësi merr të gjitha elementet e kontrollit që zakonisht i përkasin aksionarëve apo administratorëve:
- **Kontroll mbi të ardhurat dhe llogaritë:** Të gjitha të ardhurat e Aeroportit të Vlorës (receivables) dhe të gjitha llogaritë bankare (Project Accounts) janë të vendosura nën barrë në favor të huadhënësit të panjohur, i cili përcakton mënyrën e përdorimit të tyre.
- **Veto mbi vendimmarrjen:** Çdo ndryshim i dokumenteve statutoresë ose i kontratës koncesionare kërkon miratimin e huadhënësit, duke i dhënë atij kompetenca të barabarta me një aksionar kontrollues.
- **Ngjarje default-i të zgjeruara:** Lista e gjerë e shkaqeve të default-it (ndryshim kontrolli, vonesa, mosmarrëveshje me autoritetet, pezullim i punimeve, etj.) i jep huadhënësit mundësinë të marrë kontroll praktikisht në çdo moment.
- **Pamundësia e parapagimit:** Ndalimi i parapagimit për 5 vitet e para dhe penalitetet pas këtij afati e bëjnë marrëveshjen të pashmangshme dhe e lidhin shoqërinë koncesionare në mënyrë të pakthyeshme.
- **Accession i VIA-s si Borroëer shtesë:** Mekanizmi i Accession Letter e kthen vetë shoqërinë koncesionare në huamarrëse, duke e ngarkuar me detyrimet e huasë që fillimisht ishte në emër të aksionarit.

Pasoja: Këto elemente të kombinuara prodhojnë një rezultat të qartë: Shoqëria koncesionare humbet pavarësinë financiare dhe vendimmarrëse; Huadhënësi fiton kontroll ekonomik mbi të gjitha flukset financiare të projektit; Aksionarët mbeten formalë, ndërsa pushteti real kalon tek kreditori.

Konkluzioni: Ky instrument juridik arrin të njëjtin efekt si shitja e aksioneve, por pa një kontratë shitjeje të hapur. Pra, kemi të bëjmë me një shitje të maskuar. Një strukturë e ndërtuar posaçërisht për të transferuar kontrollin e aeroportit të huadhënësi, nën petkun e një marrëveshjeje huaje.

29. Shpjegojmë se, kjo kontratë kredie dhe refuzimi i aplikimit të saj në VIA nga ish-administratori Valon Lluka ka qenë shkaku real i shkarkimit të këtij të fundit, përmes një procedure të paligjshme nga Shoqëria Mabco. Ky i fundit, i vënë në dijeni të këtij qëllimi, jo vetëm të paligjshëm dhe në kundërshtim me Statutin e VIA-s, por edhe të rrezikshëm, pasi cenon vetë interesat kombëtare të shtetit shqiptar, është drejtuar me *e-mail* administratorit të Shoqërisë Mabco, duke i kërkuar që të heqe dorë nga kjo marrëdhënie huaje.

30. Duke çmuar të gjitha këto rrethana dhe rrezikun për dëmtimin e rëndë dhe të pakthyeshem të interesave të Shoqërisë “2A Group” si ortakut tjetër të shoqërisë VIA, si rrjedhojë e veprimeve të paligjshme të ortakut majoritar (me 51% të kuotave), “Mabco Construction SA”, vlerësojmë se duhet t'i drejtohem Gjykatës fillimisht me kërkesë për marrjen e masës së sigurimit të padisë, e në vijim me kërkesëpadi për kundërshtimin e këtyre veprimeve të këtij ortakut.

Kërkuesi parashtron se, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka kompetencë tokësore për shqyrtimin e kësaj kërkeje, bazuar kjo në parashikimet e nenit 43 të K.Pr.Civile.

Në lidhje me legjitimitetin, vlerësojmë se kërkuesi, Shoqëria “2A Group” ka legjitimitet aktiv në paraqitjen e kësaj kërkeje, legjitimitet që buron nga nevoja e rivendosjes së një interesi dhe të një të drejte të cenuar nga veprimet e paligjshme të Shoqërisë “Mabco Construction SA” që shfaqen në veprimet për përvetësimin e investimeve dhe kuotave të zotëruara *de facto* nga kërkuesi në Shoqërinë VIA.

31. Bazuar në faktet e relatuara më lart, evidentohet qartë që një prej ortakëve të Shoqërisë VIA ka vepruar në kundërshtim të hapur jo vetëm me interesat e kësaj shoqërie, por edhe me interesat e ortakut tjetër, veprime këto që kanë patur në çdo moment si qëllim përvetësimin e kuotave faktike si dhe investimeve të kësaj të fundit në Shoqërinë VIA, veprim ky i kryer me qëllim zotërimin dhe disponimin lirisht të projektit për të cilin është lidhur Kontrata Koncesionare, të cilin qartësisht e ka tjetërsuar të një huadhënës i paidentifikuar.

32. Kjo veprimtari e paligjshme e Shoqërisë “Mabco Construction” është shfaqur në marrjen në më shumë se një herë të vendimeve që në fakt duhet të ishin miratuar në mbledhjen e Asamblesë të Përgjithshme të VIA-s, por që në fakt janë miratuar nga vetëm një ortak i vetëm i kësaj shoqërie në kundërshtim kjo me parashikimet e neneve 81 e 87 të ligjit 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe me Statutin e Shoqërisë VIA.

33. Shkelja e këtyre parashikimeve ligjore dhe statutore shfaqet fillimisht në momentin e ndryshimit të adresës së Shoqërisë VIA, vendim ky për të cilin nuk ishte njoftuar më parë një mbledhje me Asamblesë së Ortakëve. Kjo veprimtari e paligjshme ka kulmuar me marrjen e vendimi tjetër, për ndalimin e tjetërsimit të kuotave të Shoqërisë Mabco, vendim i cili jo vetëm që nuk është vendim i Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë VIA, por përkundrazi është vendim i Shoqërisë “Mabco Construction”, shoqëria mëmë, me qendër në Lugano, pra i njërit prej ortakëve të VIA-s. Në funksion të arritjes së qëllimit për të cilin ishte marrë ky vendim, në kundërshtim me Statutin e Shoqërisë VIA, si dhe parashikimet e ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, ai është publikuar në QKB si një vendim i VIA-s, kur në fakt nuk ishte e vërtetë, gjë që përbën abuzim të hapur me formën e ushtrimit të veprimtarisë të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, me pasojë pavlefshmërinë e këtij veprimi.

34. Publikimi i këtij vendimi të paligjshëm (për shkak se jo vetëm që ishte i ortakut, por edhe në vetvete ai përmban edhe disponim për kuota që Shoqëria Mabco i kishte tjetërsuar) në QKB ka si qëllim përvetësimin e kuotave që zotëron *de facto* në Shoqërinë VIA, ortakut tjetër Shoqëria “2A Group” të VIA, që janë 49% e tyre. Ky përvetësim ka një qëllim final që lidhet me dhënien jetë të një marrëveshjeje të fshehtë që Shoqëria “Mabco Construction SA” kishte lidhur përmes *Delfos* me një huadhënës të fshehtë, të paidentifikuar, përmes të cilës shoqëria VIA dhe projekti i Kontratës Koncesionare ishte vënë në zotërim real të këtij të fundit (kredidhënësit).

35. Kjo marrëveshje e fshehtë e Shoqërisë “Mabco Construction SA”, për sigurimin e një kredie që financon projektin e kontratës së koncensionit, është lidhur me këtë kredidhënës jo vetëm pa e shtruar më parë këtë çështje

për diskutim dhe miratim në Mbledhjen e Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë VIA, por edhe pa dijeninë e Autoritetit Kontraktor që është MIE. Të gjitha këto tregojnë se veprimet e kryera nga ortaku i VIA-s, Shoqëria “Mabco Construction SA” janë në dëm të interesave të Shoqërisë VIA-s, politikave të saj financiare, me qëllim jo vetëm përvetësimin e kuotave që zotëron në shoqëri ortaku tjetër, por në thelb me interesin përfundimtar atë të kalimit të vetë projektit në zotërim të kredidhënësit të panjohur, i cili në mënyrë faktike, për shkak të veprimeve të paligjshme është bërë palë në kontratën koncesionare.

36. Në funksion të këtij qëllimi janë edhe veprimet e mëposhtme të Shoqërisë “Mabco Construction SA” të cilat janë në kundërshtim të hapur me ligjin për shoqëritë tregtare dhe vetë Statutin e Shoqërisë VIA, të cilat lidhen me:

- Kryerjen e veprimeve duke paraqitur një gjendje jo reale të ndarjes së kuotave në Shoqërinë VIA dhe një situatë jo-reale të investimeve dhe kontributit të ortakëve në këtë shoqëri.
- Shkarkimin e ish-administratorit Valon Luka, përmes një procedure të pavlefshme, për shkak se mbledhja e Asamblesë së Ortakëve është njoftuar 5 ditë para zhvillimit të saj, veprim, në kundërshtim me nenin 83 të ligjit 9901, dt. 14.04.2008 (të cilin afati i njoftimit është minimumi 7 ditë). Shkarkimi i këtij administratori u bë për shkakun se ai refuzoi implementimin në Shoqërinë VIA të kontratës së kredisë të nënshkruar përmes ndërmjetësimit të Delfos me një huadhënës off-shore, i cili në kundërshtim me ligjin dhe kontratën është bërë pjesë e Kontratës së Koncesionit.
- Emërimit në kundërshtim me dispozitat statutoire të një administratori të ri Z. Mentor Hasaj, i cili edhe ai është larguar me dorëheqje, pasi është vënë nën presion për të firmosur të njëjtën marrëveshje të paautorizuar financimi;
- Ndryshimin e Statutit të Shoqërisë, ku në Draft Statutin e paraqitur për miratim Shoqëria “Mabco Construction SA” mundohet t’u japë jetë përpjekjeve të saj për përvetësimin e kuotave dhe investimeve të ortakut tjetër, përmes parashikimit të klauzolave që cenojnë kontratën e shitblerjes dhe paraqitjes të një ndarje jo faktike të kuotave në mes ortakëve, veprim ky i cili bie haptazi ndesh me jo vetëm me kontratën e shitblerjes (paramarrëveshjen dhe marrëveshjen), por edhe me vendimet e mëparshme të Mabcos (mbledhja e datës 20.07.2023) në të cilën është miratuar ky tjetërsim kuotash në masën 47%.

37. Nisur sa më sipër, është e qartë së Shoqëria “Mabco Construction SA”, përmes këtyre veprimeve, po cenon haptazi interesat e shoqërisë VIA (neni 14 i ligjit 9901, dt. 14.04.2008), për shkak se ky ortak:

- *Me dashje i ka shkaktuar dëme shoqërisë VIA dhe ortakut tjetër, dëm ky që shfaqet në ekspozimin e VIA dhe ortakut në një marrëdhënie kredie e cila është në dëm të interesave të shoqërisë dhe projektit për të cilin është krijuar ajo;*
- *Me dashje ka shkelur Statutin e Shoqërisë, si dhe detyrimet e përcaktuara me ligj, gjë që shfaqet në marrjen e vendimeve dhe kryerjen e veprimeve pa miratim të VIA-s, por miratim të vetë kësaj shoqërie, që nga ana tjetër është vetëm një prej ortakëve të shoqërisë. Nga sa evidentohet nga veprimet e pasqyruara më lart në çdo vendimarrje, Mabco ka përjashtuar ortakun tjetër, Shoqërinë “2A Group”, i cili, nga ana tjetër, është investitori real për financimin e projektit të Kontratës Koncesionare;*
- *Është përfshirë në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut; për shkak të gjendjes së rrezikut në të cilën ka vënë VIA, ortakun tjetër dhe në analizë të fundit vetë objektin e kontratës.*
- *Me veprimet e tij ka dëmtuar ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë, e cila aktualisht nuk mund të vijojë normalisht për shkak të mosmarrëveshjeve të krijuara mes ortakëve.*

38. Ndodhur në këto kushte, duke çmuar se Shoqëria “Mabco Construction SA”, me veprimet e saj, tregon se është e vendosur të realizojë qëllimin e këtyre veprimeve, pavarësisht paralajmërimeve të përsëritura të ortakut tjetër, mendojmë se ajo duhet të ndalohet në këtë veprimtari nga Gjykata. Nevoja për t’iu drejtuar Gjykatës për ndalimin e kësaj veprimtarie bazohet në parashikimet e nenit 93 të ligjit 9901, dt. 14.04.2008 (me qëllim shfuqizimin e vendimeve të padrejta), në kushtet që mbi këto vendime nuk është arritur të merret një vendimarrje brenda vetë

shoqërisë. Në këto kushte, me qëllim mbrojtjen e interesave të tij dhe të vetë Shoqërisë VIA, ortakut tjetër është i detyruar t'i drejtohet Gjykatës me kërkesë-padi me objekt *“Shfuqizimin e këtyre vendimeve të paligjshme të Shoqërisë Mabco si dhe rregullimin e pasojave që ato vendime kanë prodhuar”*.

39. Pavarësisht kësaj, ndodhur në kushtet e nevojës emergjente që lidhet me rrezikun që mund të vijë nga vijimi i kësaj veprimtarie të paligjshme nga Shoqëria Mabco, e cila duket se do të vijojë në mbledhjen e radhës të caktuar nga ana e saj të datës 20.10.2025, mendojmë se duhet t'i drejtohem paraprakisht Gjykatës me kërkesë për marrjen e masës së sigurimit të padisë. Kjo kërkesë bazohet në faktin se deri në pritjen e një vendimi përfundimtar që shqyrton në themel kërkesë-padinë e shoqërisë “2A Group” ka dyshime të arsyeshme, të bazuara mbi akte shkresore se Shoqërisë VIA mund t'i shkaktohet një dëm i rëndë e i pakthyeshëm dhe rrjedhimisht se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë, deri sa rrezikohet që të mos ekzistojë fare pozita e ortakut të pakicës, duke parë këtë në frymën e ndryshimeve të statutit të ri të shoqërisë të cilat “eliminohen” pozitën e ortakut të pakicës.

40. Kjo kërkesë, për shkak të kushteve të emergjencës, paraqitet para paraqitjes së padisë në themel, veprim ky i lejuar nga parashikimet e nenit 204 të K.Pr.Civile.

41. Evidentohet se, nga e gjithë kjo kronologji veprimesh po tentohet që të anashkalohej plotësisht parashikimi i nenit 78 të ligjit për shoqëritë tregtare pasi Asambleja e Përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të këtij ligji, për ndryshimin e statutit. Ndërkohë me propozimin për thirrjen e Asamblesë së Ortakëve të datës 20.10.2025 dhe nga leximi i rendit të ditës po tentohet që të miratohet ndryshimi i statutit që “eliminon” ortakun e pakicës, i cili në fakt zotëron 49% të kuotës në këtë shoqëri, ndërkohë që shoqëria kërkon që, përmes këtyre artificave, të miratojë statutin duke e konsideruar 2% zotërimin e kuotës nga ortakut i pakicës, me pasojë humbjen e investimit në proporcion me vlerën reale të kuotës që zotëron si dhe kontrollin e plotë vendimarrës me 3/4, nëse kjo gjë lejohet të ndodhë në mbledhjen e datës 20.10.2025.

42. Kjo përbën pikërisht shkakun për të cilin kërkojmë marrjen e masës së sigurimit të padisë, me qëllim që të mos realizohen veprime nga Asambleja e Shoqërisë, të cilat do të ishin një skemë e mirëmbledhur për cenimin e pozitës së ortakut dhe tejkalimin të parashikimit ligjor si mjet efektiv kontrolli në shoqëri përmes veprimesh të paligjshme të pozitës së ortakut të pakicës. Kjo gjë nuk është as qëllimi dhe as fryma e ligjit. Jo më kot ligjvënësi ka parashikuar nenin 78 të ligjit për shoqëritë tregtare, për marrjen e vendimeve me shumicë të cilësuar për këtë lloj vendimarrje, pikërisht që të shmangë çdo mjet tjetër të paligjshëm që tenton të cenojë pozitën e ortakëve dhe politikën vendimarrëse të shoqërisë duke mos e lënë kontrollin e shoqërisë në duart e një ortakut të pakufizuar që kontrollon çdo vendimarrje pas kësaj i pashqetësuar.

Në këtë drejtim, duam të theksojmë faktin se lejimi i vijimit të kësaj veprimtarie nuk e cenon ortakun e pakicës vetëm në drejtim të kuotave dhe vlerës së investimit të tij në projektin e Kontratës Koncesionare (rreth 23 milion euro), por e dëmton atë edhe në drejtim të fitimit të munguar të cilin ai rrezikon ta humbasë plotësisht nëse lejohet të miratohet rendi i ditës i mbledhjes thirrur më datën 20.10.2025 nga aksioneri “Mabco Contruction SA”. Për të provuar këtë vlerë të lartë dëmi shpjegojmë se, bazuar në Bussines Planin referuar “Accumulated Cash Floë”, pritshmëria për shumën që do të kthehet nga investimi për ortakët pas 35 vitesh është në vlerën e 734.000.0000 (pas 35 vitesh x 0.49%) rezulton një dëm në vlerën e 359.660.000 euro vetëm si fitim i munguar. (Prova studimi Bussines Plan-BDO).

43. Në këtë mënyrë, masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor, nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve përkatëse në çdo shkallë gjykimi, në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 13 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

44. Sigurimi i padisë, si institut procedural është parashikuar, me qëllim shmangien e rrezikut të ekzekutimit të vendimit dhe, për këtë arsye, bëhet përpara se të jetë vërtetuar vullneti i ligjvënësit që garanton një të mirë të caktuar, apo përpara se të bëhet i mundur realizimi i të drejtës nëpërmjet ekzekutimit të detyrueshëm. (Shih vendimin *unifikues nr. 10 datë 24.03.2004 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*).

45. Sigurimi i padisë, si institut juridik procedural, nënkupton një vlerësim paraprak dhe sipërfaqësor të fakteve të çështjes nga gjykata, e cila, nëse arrin në përfundimin se, ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit të themelit për të drejtat e paditësit (kërkuesit) do të shkaktonte një dëm të rëndë, të pakthyesëm dhe të atëçastshëm për paditësin dhe njëkohësisht nuk duhet të cenohet rëndë interesi publik, lejon marrjen e saj. Madje në këtë rast kemi dhe tentativë për cenimin e interesit publik sa kohë që kemi të bëjmë me pasoja që do të vijnë mbi kontratën koncesionare nëse lejohen civilisht të ndodhin këto ndryshime përmes mbledhjes së asamblesë së thirrur duke u përdor ortakët për tjetërsime të mëtejshme me pasojë fundore cenimin e interesit publik.

46. Koncepti kushtetues i interesit publik, ashtu siç është trajtuar në praktikë të vazhdueshme nga Gjykata, është mjaft i gjerë dhe duhet parë në këndvështrimin e dispozitës konkrete që paraqitet për kontroll para saj. Është e vështirë të radhiten në mënyrë shteruese çështjet që përbëjnë interes publik ose të arsyen publike që mund të justifikojnë ndërhyrjen në një të drejtë themelore. Ato mund të renditen vetëm negativisht, pra në aspektin e kufizimit të çdo rasti konkret.

47. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues nr. 10, datë 24.03.2004, kanë mbajtur qëndrimin se, *“...Gjykatat vendimin për marrjen e masës së përkohshme për sigurimin e padisë nuk duhet ta mbështesin në fakte apo veprime, si dhe në cilësimin juridik të tyre, që kanë të bëjnë me shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjes në themel. Gjithashtu shqyrtimi i kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë duhet të trajtohet në një mënyrë të tillë që të shmangë çdo lloj perceptimi, sipas të cilit gjykata e ka paragjykuar zgjidhjen e çështjes në themel apo nuk është e pa anshme në gjykim.”*

48. Kërkuesi, në këtë rast, po kërkon të sigurojë parapakisht pozitën e tij në shoqëri që po tentohet në disa forma të paligjshme njëra pas tjetrës, si dhe garancitë që njeh ligji për marrjen e vendimit për ndryshimin e statutit dhe moslejimin e kryerjes së veprimeve të paligjshme në mashttrim të ligjit me masë të përkohshme të sigurimit të padisë si njëti i vetëm efektiv për parandalimin e çdo pasoje të mëvonshme.

49. Ndryshe, nëse gjykata nuk e pezullon vendimarrjen sipas rendit të ditës së propozuar, nuk do të kishte kuptim vazhdimi i gjykit të çështjes sepse ajo do të ishte e paragjykuar dhe e paravendosur fati i padise së themelit dhe nuk do kishte kthim prapa edhe sikur paditësi, në eventualitet të pranimit të padisë, të ripozicionohej në pozitën e tij reale në shoqëri.

50. Llojet e tjera të masave të sigurimit të padisë, sipas parashikimit të pikës “b” të nenit 206 të K.Pr.Civile, përveç masës së pezullimit të ekzekutimit, janë të papërcaktuara në mënyrë konkrete. Kjo do të thotë se gjykata, rast pas rasti, ka diskrecion të vendosë një masë të natyrës së sigurimit të padisë që ajo e gjykon të përshtatshme dhe të dobishme për të mbrojtur të drejtat e paditësit, por pa rrezikuar në të njëjtën kohë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të të paditurit. Në këto raste, marrja e masave të përkohshme të sigurimit të padise synon “ta mbajë gjendjen ashtu siç është”, apo “të ngrirë”, deri në zgjidhjen përfundimtare të konfliktit, e cila, për vetë natyrën e çështjes, duhet të realizohet nëpërmjet një procedure të shpejtë dhe relativisht të thjeshtë, duke u kujdesur, gjithsesi, që të respektohet një standard i pranueshëm i një procesi të rregullt ligjor.

51. Në përfundim, mund të themi me bindje se plotësohen parakushtet për pranimin e masës së sigurimit të padisë pasi:

a) Provohet mbi akte shkresore dhe jo hipotetike ekzistenca e mundshme e një të drejte për të cilën kërkohet një mbrojtje në gjykim themeli (Neni 202/a)

b) Një frikë e bazuar që ekzekutimi i vendimit për të drejtën për të cilën kërkohet mbrojtje në procesin e gjykit të padisë të bëhet i pamundur ose i vështirë (Neni 202/b)

52. Përsa më sipër, vlerësojmë se palës kërkuese do t’i shkaktohet një dëm i pariparueshëm ndaj dhe marrja e masës së sigurimit të padisë për të pezulluar vendimarrjen e caktuar në rendin e ditës nga pala e paditur shoqëria VIA është e vetmja mënyrë për të frenuar abuzimin në këtë shoqëri nga ortakët e shumicës.

Theksojmë se, brenda afatit përkatës procedural të parashikuar në Kodin e Procedurës Civile, do vijojmë me

depozitimin e kërkesëpadisë së themelit për pavlefshmëritë e shkarkimeve dhe emërimeve të administratorëve si dhe për pavlefshmëritë e njëpasnjëshme të vendimeve të asamblesë të shoqërisë të cilat cenojnë jo vetëm pozitën e ortakut, por edhe vetë kontratën e koncensionit për qëllimin që duan të arrijnë.

Për sa më sipër kemi parashtruar dhe provojmë, kërkojmë pranimin e kërkesës dhe marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke pezulluar marrjen e çdo vendimi në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë “Vlora Internacional Aeroport- VIA” SH.P.K. të njoftuar për t’u mbajtur me datën 20.10.2025 sipas atij rendi dite, deri në zgjidhjen e çështjes me një vendim të formës së prerë; pezullimin e të drejtës së votës të ortakut të shumicës, Shoqëria “Mabco Construction SA” deri në regjistrimin e kontratës së shitjes së kuotave të datës 03.04.2025 me objekt transferimin e kontratës së shitjes së kuotave të datës 03.04.2025 për transferimin e 49% të kuotave të kapitalit të shoqërisë VIA sh.p.k. tek blerësi “2A Group” sh.p.k.

Vlerësimi i gjykatës.

a. E drejta objektive ku bazohet vendimi.

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj të konsoliduar, ka theksuar se: *“Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individ i ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar.”* (Vendimi nr. 59, datë 24.12.2012, i Gjykatës Kushtetuese).

Në disa raste, ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë që njeh dhe rivendos në vend një të drejtë apo interes të ligjshëm që i është shkelur palës paditëse, bëhet i pamundur ose i vështirë, për shkak të sjelljeve të palës tjetër gjyq-humbëse. Për këto arsye bëhet e nevojshme marrja e masave për të siguruar ekzekutimin e vendimit.

Kështu, në nenin 202 të K.Pr.Civile, parashikohet se: *“Me kërkesën e paditësit, gjykata brenda 5 ditëve lejon marrjen e masave për sigurimin e padisë, kur ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë. Sigurimi i padisë lejohet kur: a) padia mbështetet në prova me shkresë; b) paditësi jep garanci, në masën dhe në llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t’i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë. Garancia mund të kërkohej edhe për rastin e parashikuar nga shkronja “a” e këtij neni.”*

Në interpretim të kësaj dispozite, që gjykata të lejojë marrjen e masave për sigurimin e padisë duhet të plotësohen bashkërisht (në mënyrë kumulative) të gjitha kushtet e mëposhtme:

1. Së pari, ekzistenca e mundshme e një të drejte për të cilën kërkohet mbrojtje në procesin e gjykimit të padisë. (Vendimi i Gjykatës së Lartë nr. 22, datë 19.01.2011). Këtu nuk është e nevojshme që të jetë vërtetuar plotësisht ekzistenca e së drejtës që është edhe objekti i shqyrtimit gjyqësor dhe që ka lidhje me themelin e çështjes, por vetëm **mundësia** e ekzistencës së të drejtës që kërkohet të rivendoset.

2. Së dyti, ekziston rreziku (ka arsye të dyshohet) që ekzekutimi i vendimit të formës së prerë, apo me fjalë të tjera, përmbushja e detyrimit që përmban vendimi gjyqësor si titull ekzekutiv, të bëhet i pamundur ose i vështirë. **Kur flasim për ekzistencën e rrezikut apo “dyshimin e arsyeshëm” duhet të kemi parasysh se standardi i të provuarit duhet të jetë i tillë, që të krijojë te gjykata (gjyqtari) dyshimin se ekziston rreziku dhe jo bindjen e plotë për ekzistencën e tij.**

3. Së treti, nëse padia mbështetet në prova me shkresë ose paditësi jep garanci, në masën dhe në llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t’i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë. Paraqitja nga paditësi e provave me shkresë është e nevojshme për të krijuar te gjykata besimin se është e mundshme ekzistenca e të

drejtës subjektive të pretenduar. Duhet theksuar se, nuk kërkohen prova me shkresë për të vërtetuar se ekziston rreziku që ekzekutimi i vendimit të bëhet i pamundur ose i vështirë. Arrihet në këtë konkluzion, nisur nga interpretimi literal dhe gjuhësor i nenit 202, pika “a”, e cila thotë se në prova me shkresë mbështet “padia”, me të cilën, sipas nenit 31 të K.Pr.Civile, kuptohet e drejta e personit që bën pretendimin për t’u dëgjuar mbi themelin e këtij pretendimi, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar ose jo. Në këtë kuptim, me fjalë të tjera, në prova me shkresë mbështetet pretendimi i paditësit se i është shkelur një e drejtë subjektive që i përket dhe për të cilën kërkon rivendosjen.

Gjithashtu, nëse do të pranonim që kërkohen prova me shkresë për të vërtetuar se ekziston rreziku që ekzekutimi i vendimit të bëhet i pamundur ose i vështirë, në gjykim duhej të kishte debat në lidhje me provat dhe fuqinë e tyre provuese, për faktet që lidhen me ekzistencën e rrezikut. Por, siç arsyeton Gjykata e Lartë në vendimin nr. 227, datë 08.05.2012, *“gjykata nuk ka asnjë të drejtë që të bëjë vlerësimin e provave shkresore të paraqitura nga kërkuesi, sepse kjo do ta çonte atë në paragjykimin e zgjidhjes së çështjes në themel, duke cenuar parimin e rëndësishëm të zhvillimit të rregullt të një procesi gjyqësor, të parashikuar nga neni 4 i K.Pr.C.”.*

Në lidhje me institutin e sigurimit të padisë, Gjykata e Lartë, në vendimin unifikues nr. 10, datë 24.03.2004, arsyeton se: *“gjykatat vendimin për marrjen e masës së përkohshme për sigurimin e padisë nuk duhet ta mbështesin në fakte apo veprime, si dhe në cilësimin juridik të tyre, që kanë të bëjnë me shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjes në themel. Gjithashtu shqyrtimi i kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë duhet të trajtohet në një mënyrë të tillë që të shmangë çdo lloj perceptimi sipas të cilit gjykata e ka paragjykuar zgjidhjen e çështjes në themel apo nuk është e paanshme në gjykim.”*

Llojet e masave që mund të merren nga gjykata për sigurimin e padisë, parashikohen në nenin 206 të K.Pr.Civile, sipas të cilit: *“Sigurimi i padisë bëhet: a) me sekuestrimin e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe të kredive të debitorit; b) me anë të masave të tjera të përshtatshme të marra nga gjykata. Gjykata mund të lejojë sigurimin e padisë me disa nga llojet e ndryshme të masave të sigurimit, por gjithmonë për një shumë të përgjithshme jo më të madhe se atë të padisë. Sekuestër nuk mund të vihet mbi sende që, sipas nenit 529 të këtij Kodi, nuk mund të sekuestrohen.”*

Në lidhje me llojet e masave që mund të marrë gjykata sipas nenit 206 të K.Pr.Civile, Gjykata e Lartë në vendimin unifikues të sipërcituar, arsyeton se: *“masa kryesore e përkohshme e sigurimit të padisë është ajo e parashikuar në pikën “a” të dispozitës së mësipërme: sekuestrimi i sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe i kredive të debitorit. Kjo quhet sekuestro konservative. Sekuestro konservative mund të vendoset në qoftë se gjyqtari (gjykata) krijon bindjen se kreditori (paditësi) ka motiv për t’u shqetësuar se debitori (i padituri), përpara se të merret një vendim gjyqësor që të vërtetojë të drejtën e tij dhe të urdhërojë rivendosjen e saj apo shpërblimin e dëmit eventual, do të zvogëlojë apo do të fshehë pasurinë e tij... Sekuestrimi i të hollave apo i kredive bëhet duke urdhëruar depozitimin e tyre në një institucion bankar dhe ngrirjen e tyre, apo ngrirjen e depozitave bankare, të llogarive rrjedhëse, etj., të debitorit.”*

b. Analiza e çështjes.

Në këtë çështje, gjykata vlerëson se kërkesa për marrjen e masës së sigurimit të padisë është e bazuar në ligj dhe prova, prandaj duhet pranuar.

Në nenin 204 të K.Pr.Civile, parashikohet se: ***“Sigurimi i padisë mund të kërkohet edhe përpara ngritjes së padisë në gjykatën e vendit ku ka banimin paditësi ose ku ndodhet pasuria me të cilën do të sigurohet padia”.***

Lidhur me kërkesën për masën e përkohshme të sigurimit të padisë, Gjykata vlerëson të vërejë se nëpërmjet vendimit të saj nuk duhet të nxirren përfundime që i përkasin shqyrtimit dhe zgjidhjes së çështjes në themel, në

përputhje me konkluzionet e arritura në Vendimin Unifikues Civil Nr. 10, datë 24.03.2004, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku theksohet, ndër të tjera se: ***“Gjykatat vendimin për marrjen e masës së përkohshme për sigurimin e padisë nuk duhet ta mbështesin në fakte apo veprime, si dhe në cilësimin juridik të tyre, që kanë të bëjnë me shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjes në themel... Gjithashtu, shqyrtimi i kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë duhet të trajtohet në një mënyrë të tillë që të shmangë çdo lloj perceptimi sipas të cilit gjykata e ka paragjykuar zgjidhjen e çështjes në themel apo nuk është e paanshme në gjykim.”***

Sipas nenit 206 të K.Pr.Civile, “Sigurimi i padisë bëhet: a) me sekuestrimin e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme si dhe të kredive të debitorit...”. Pra, masa kryesore e përkohshme e sigurimit të padisë është ajo e parashikuar në pikën “a” të dispozitës së mësipërme: sekuestrimi i sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme si dhe i kredive të debitorit, e quajtur “*sekuestroja konservative*”. Sekuestroja konservative mund të vendoset në qoftë se gjyqtari (gjykata) krijon bindje se kreditori (paditësi) ka motiv për t’u shqetësuar se debitori (i padituri), përpara se të merret një vendim gjyqësor që të vërtetojë të drejtën e tij dhe të urdhërojë rivendosjen e saj apo shpërblimin e dëmit eventual, do të zvogëlojë apo do të fshehë pasurinë e tij. Sekuestrimi i sendeve të paluajtshme bëhet duke urdhëruar Agjencinë Shtetërore të Kadastrës që të ndalojë shitjen, dhurimin apo çdo lloj disponimi të tyre.

Gjykata konstaton se:

Shoqëria “Vlora International Airport – VIA” sh.p.k., NUIS “M11809002I”, është një shoqëri tregtare e regjistruar në QKB më dt. 09.06.2021, me objekt të veprimtarisë së saj: ***“Zbatimi i Kontratës së Koncesionit nënshkruar ndërmjet ortakëve të shoqërisë (Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë të shpallur fitues në procedurën e tenderit) dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, që në mënyrë të veçantë, ndër të tjera, do të konsistojë në projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA).***

Në zbatim të Kontratës së Koncesionit të dt. 15.06.2021, të lidhur mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Shoqërisë “Vlora International Airport- VIA” sh.p.k., Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë të shoqërive përbëhej nga shoqëritë “2A Group” sh.p.k. (përfaqëson 2% të kapitalit të shoqërisë), “Mabco Construction SA” (përfaqëson 58% të kapitalit të shoqërisë) dhe Shoqëria “YDA INSAAT SANAYI TICARET” (përfaqëson 40% të kapitalit të shoqërisë). Kjo e fundit, më datën 08.09.2022, me kontratën noteriale me nr. 5949 rep. dhe 2120 kol., i shet 40% të kuotave të saj në Shoqërinë “Vlora International Airport- VIA” sh.p.k. shoqërisë “Mabco Constructions SA”.

Rezulton nga aktet se, dy shoqëritë ortakë, respektivisht shoqëria “Mabco Constructions SA” dhe shoqëria “2A Group” sh.p.k., lidhin një marrëveshje të titulluar “Parakontratë për shitblerje të kuotës së aksioneve” dt. 20.06.2022.

Në vijim, rezulton nga aktet se, dy shoqëritë ortakë, respektivisht shoqëria “Mabco Constructions SA” dhe shoqëria “2A Group” sh.p.k., kanë konkluduar “Marrëveshje Shitje & Blerje”, dt. 19 qershor 2024, ku pasqyrohet fakti se, shitësi, “Mabco Constructions SA”, pronar i një kuote që përfaqëson 98% të kapitalit të shoqërisë “VIA” sh.p.k., synon të shesë 47% të pjesëmarrjes së tij tek blerësi, shoqëria “2A Group”, në përfundim të të cilës, shitësi do të zotërojë 51% të kapitalit të shoqërisë “VIA” sh.p.k., ndërsa blerësi do të zotërojë 49% të këtij kapitali. Në këtë akt, palët kanë rënë dakord mbi termat e marrëveshjes, shumën e pagueshme nga blerësi, mënyrën e pagesës, etj.

Palët kontraktore kanë rënë dakord që, titulli dhe pronësia e kuotës do të konsiderohet se transferohet nga shitësi tek blerësi në datën e nënshkrimit të këtij dokumenti. Krahës kalimit të titullit dhe pronësisë nga shitësi tek blerësi, gjithashtu transferohen edhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet rrjedhëse të lidhura me kuotën, sikurse janë e drejta për fitim, e drejta e votës, etj. (neni 3 i Marrëveshjes).

Më herët, më dt. 20.07.2023, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve të shoqërisë “Mabco Constructions SA” ka vendosur të miratojë shitjen e 47% të aksioneve të shoqërinë VIA sh.p.k. tek shoqëria “2A Group” sh.p.k.

Më dt. 03.04.2025, palët, respektivisht shoqëria “Mabco Constructions SA” dhe “2A Group” sh.p.k., lidhin

“Marrëveshje për Shitblerjen e Kuotës”, akti noterial nr. rep. 2437, nr. kol. 941/1, dt. 03.04.2025, redaktuar nga notere Valbona Selimi, nëpërmjet të cilës përcaktojnë shitblerjen e kuotës prej 47% të kapitalit të shoqërisë “VIA” sh.p.k. Kalimi i shumës së shitblerjes kryer me transaksionin bankar të datës 12.07.2024, me numër transaksioni 68100563540004.

Më herët, edhe Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve të 2A Group sh.p.k. ka vendosur të miratojë blerjen e kuotës që përfaqëson 47% të kapitalit themeltar të shoqërisë “VIA” sh.p.k.

Rezulton, se është miratuar Akti i Themelimit dhe Statuti i shoqërisë “Vlora International Airport – VIA” sh.p.k., me efekt nga dt. 17.05.2021.

Konform kontratës për shitblerje të kuotave dt. 03 prill 2025, si dhe kuadrit ligjor rregullator, me nënshkrimin e kësaj aktmarrëveshjeje, prej kësaj date, në Shoqërinë “Vlora International Airport – VIA” sh.p.k., zotërimi i kuotave ndahet në këto raporte takuese: 49% shoqëria “2A Group” sh.p.k. dhe 51% shoqëria “Mabco Constructions SA”.

Rezulton, referuar akteve shkresore të dosjes gjyqësore, se shoqëria “Mabco Constructions” SA”, ortak i shoqërisë “VIA” sh.p.k., ka marrë vendim dt. 21.08.2025, duke vendosur kufizimin e çdo transferimi pronësie (të kaluar, të tashëm apo të ardhshëm) të kuotave të zotëruara nga Mabco në kapitalin themeltar të “Vlora International Airport-VIA” sh.p.k., deri në një vendimmarrje të dytë dhe të regjistrimit të tyre në QKB.

Më dt. 01.09.2025, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë “VIA” sh.p.k. ka marrë vendimin për shkarkimin e administratorit të shoqërisë z. Valon Lluka dhe emërimin e administratorit të ri z. Mentor Hajdaraj.

Përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë “2A Group” sh.p.k., z. Valon Ademi i është drejtuar më datën 25.08.2025 Shoqërisë “Vlora International Airport” sh.p.k., konkretisht administratorit të asokohe Valon Lluka, duke i kërkuar marrjen e masave për regjistrimin në QKB të kalimit të 47% të kuotave nga Shoqëria “Mabco Constructions SA” tek Shoqëria “2A Group” sh.p.k., si dhe duke u pasqyruar ky ndryshim në ekstraktin historik aktual të shoqërisë VIA sh.p.k. Pavarësisht kësaj, nuk janë kryer veprimet e kërkuara për të pasqyruar në QKB si dhe ekstraktin historik të shoqërisë VIA sh.p.k. gjendjen faktike të zotërimit të kuotave mes ortakëve të saj, sipas kontratës së shitblerjes dt. 03.04.2025.

Përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë “2A Group” sh.p.k., Z. Valon Ademi i është drejtuar më 01.09.2025 me kërkesë Shoqërisë “Mabco Constructions SA”, duke kërkuar thirrjen e mbledhjes së jashtëzakonshme të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve në datën 12 shtator 2025, me rend dite: *“1. Diskutimi dhe miratimi i rritjes së kapitalit të shoqërisë nëpërmjet konvertimit në kapital të detyrimit financiar të VIA sh.p.k. ndaj 2A Group sh.p.k. në vlerën 15,000,000.00 (pesëmbëdhjetë milionë) euro, e cila përfaqëson vetëm një pjesë të detyrimeve të krijuara nga punime të kryera dhe të faturuara. 2. Vendosja e procedurave për emetimin e kuotave të reja në favor të 2A Group sh.p.k. duke reflektuar përqindjen e re të kapitalit në QKB. 3. Çështje të tjera që lidhen me administrimin dhe funksionimin e shoqërisë.”*

Në lidhje me këtë kërkesë, administratori i Shoqërisë “Mabco Constructions SA” ka kthyer përgjigje me shkresën e datës 04.09.2025, ku i ka bërë me dije Shoqërisë “2A Group” se ai nuk mund të marrë pjesë në mbledhjen e caktuar dhe kjo mbledhje të caktohet në një datë të mëvonshme.

Nuk rezulton të jetë kryer ndonjë veprim për regjistrimin e kalimit të kuotave nga shitësi tek blerësi, në QKB.

Nga aktet rezulton se, më datën 11.10.2025, Ortaku i Shoqërisë VIA sh.p.k., Shoqëria “Mabco Constructions SA”, ka njoftuar thirrjen e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë më datën 20.10.2025, ora 10:00, me rend dite:

- *Miratimin e dorëheqjes së administratorit dhe emërimin e administratorit të ri;*

- *Miratimin e shkarkimit nga detyra të Drejtorit Teknik dhe emërimin e Drejtorit Teknik të ri;*

- *Miratimin e kontratës standarde të shërbimit për marrëdhëniet shoqëri – administrator;*
- *Miratimin e Statutit të Ri të shoqërisë;*
- *Emërimin e auditorëve statutor;*
- *Kryerjen e hetimi të posacëm mbi veprimtarinë e shoqërisë në aspektin teknik-financiar si dhe ekspertëve përkatës;*
- *Aprovimin e kontratës me kompaninë e dizenjimit X-Plan.*

Rezulton, referuar akteve, se rendi i ditës nuk përfshin ndonjë nga kërkesat e parashtruara për t'u diskutuar në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të datës 01.09.2025; njoftimi për ortakun mbi datën e caktuar për zhvillimin e mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve nuk është dërguar në formën e kërkuar nga ligji për shoqëritë tregtare dhe Statuti i Shoqërisë.

Referuar Draft-Statutit të ri, ka ndryshime thelbësore në raport me Statutin aktual të Shoqërisë VIA sh.p.k., ku konstatohet një parashikim i ri lidhur me *“përcaktimin e momentit të kalimit të kuotave, ku në nenin 2.05 është parashikuar se kalimi i kuotave lidhet me momentin e regjistrimit të këtij kalimi në QKB”*.

Gjithashtu, *Draft-Statuti i ri parashikon edhe të drejtën e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve (neni 5.01) për anulimin e kuotave, ku vendimi është parashikuar të merret me shumicë të thjeshtë dhe kjo vendimarrje është e vlefshme vetëm nëse miratohet nga ortakë që zotërojnë kuota që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e kapitalit të shoqërisë.*

Në *Shtojcën 1 të këtij Draft-Statuti është pasqyruar ndarja e kuotave mes ortakëve të Shoqërisë VIA sh.p.k. në këto raporte: Shoqëria “Mabco Constructions SA” - 98%; dhe Shoqëria “2A Group” sh.p.k. - 2%.*

Nuk rezulton të jenë pasqyruar ndryshimet në pjesët takuese të kuotave të zotëruara nga ortakët pjesëmarrës në shoqëri.

Pala kërkuese parashtroi se, shoqëria “Mabco Constructions SA”, në mënyrë të njëanshme, pa marrë miratimin edhe të ortakut tjetër të VIA sh.p.k., pra Shoqërisë “2A Group”, ka lidhur një kontratë kredie me një subjekt huadhënës të panjohur, përmes ndërmjetësimit të kësaj marrëveshje nga Delfos. Kjo kontratë kredie (e fshehtë për ortakun – Shoqërinë “2A Group”), ka si objekt dhënien e një huaje në vlerën 100.000.000 euro dhe është marrë pa miratimin e mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve të VIA sh.p.k., me qëllim realizimin/financimin e projektit të VIA, duke lënë si garanci pikërisht projektin për të cilin është lidhur Kontrata Koncesionare.

Kërkuesi, gjithashtu, parashtroi se, kjo kontratë, edhe pse në dukje është kontratë huaje, në fakt është një kontratë shitje e projektit për të cilin është lidhur Kontrata Koncesionare shoqërisë të panjohur huadhënëse/kredidhënëse. Ajo argumenton se, kjo për shkak se, përmes kësaj kontrate, Shoqëria VIA jo vetëm që ngarkohet me pagimin e detyrimeve shtesë në lidhje me interesat bankare në mënyrë të pajustificuar (interesa këto shumë më të mëdha se ato që VIA kishte me BKT), por edhe bazuar në faktin se përmes kësaj kontrate një subjekti huadhënës të panjohur i jepen tagra të ndërhyrje në të gjitha politikat financiare të Shoqërisë VIA, përmes dhënies së të drejtës për t'u njoftuar për ndryshimin e statutit, ndryshimin e administratorit, rristurimin, deri në njoftimin e saj për informacionet konfidenciale që i dërgohen MIE. Pra, përmes kësaj kontrate kredie, VIA dhe i gjithë projekti i Kontratës Koncesionare kalon në zotërimin absolut të kredidhënësit të panjohur. Veprimi për kalimin e këtyre të drejtave tek ky subjekt kredidhënës të panjohur, është kryer pa marrë miratimin e ortakut tjetër të VIA-s, por edhe pa marrë miratimin e vetë Koncesionarit (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë), duke rënë ndesh me Statutin e VIA-s, por edhe Kontratën Koncesionare datë 02.06.2021.

Kërkuesi parashtroi se, bazuar në kushtet e shlyerjes së detyrimeve financiare që burojnë nga kjo kontratë kredie, shoqëria VIA do të jetë në pamundësi të paguajë detyrimet e saj (për shkak të detyrimeve financiare të rënda në raport me planin e biznesit të miratuar me nënshkrimin e Kontratës Koncesionare), duke ekzistuar mundësia

potenciale që ky huadhënës i panjohur nga ortaku tjetër i VIA, si dhe nga Autoriteti Kontraktor (MIE), si dhe nga banka e cila e ka financuar në fillim këtë projekt BKT, të marrë projektin e kontratës, pra Aeroportin e Vlorës. Pra, në thelb, kërkuesi parashtron se, ky projekt i është shitur një huadhënësi të panjohur nga shoqëria “Mabco Constructions SA”, në mënyrë të paligjshme, duke vënë në rrezik deri edhe sigurinë kombëtare për pasojat që mund të kenë në veprën që po ndërtohet, teksa mbetet i paidentifikuar përfituesi fundor i këtyre veprimeve të paligjshme që po realizohen.

Kërkeusi parashtron se, ky “*Facility Agreement*”, ndonëse i paraqitur në formën e një marrëveshjeje huaje midis Shoqërisë “Mabco Constructions S.A.” dhe “Delphos Securities SARL”, në substancë nuk përmban karakteristikat e një huaje klasike bankare, porse elementet kontraktore dhe struktura e saj tregojnë se objektivi real nuk është thjesht financimi i projektit, por marrja e kontrollit ekonomik dhe operacional mbi aeroportin përmes instrumenteve të borxhit.

Kërkuesi thekson se, ky instrument juridik arrin të njëjtin efekt si shitja e aksioneve, por pa një kontratë shitjeje të hapur, porse një shitje të maskuar, një strukturë e ndërtuar posaçërisht për të transferuar kontrollin e aeroportit tek huadhënësi, nën petkun e një marrëveshjeje huaje.

Gjykata, duke vlerësuar *prima facie* aktet e sjella si dhe argumentet e parashtruara nga pala kërkuese, Shoqëria “2A Group”, çmon se ekzistojnë dhe janë të qenësishme kushtet dhe rrethanat që ndaj tij të bjerë rreziku mbi një dëmtim të rëndë dhe të pakthyeshëm të interesave, si njëri prej ortakëve të shoqërisë VIA sh.p.k., si rrjedhojë e veprimeve të paligjshme të ortakut të shumicës, “Mabco Constructions SA”, duke proceduar, për rrjedhojë, me pranimin e kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë.

Gjykata, teksa konstaton se, ekzistojnë disa akte të shitblerjes së kuotës prej 47% nga shitësi, Mabco Constructions SA, tek blerësi, 2A Group sh.p.k., që passjell rezultatin fundor të raportit të kuotave në masën 49% - 51% në favor të Mabco Constructions SA, në kapitalin e shoqërisë VIA sh.p.k., por të panjohura dhe të paretjektuara e pasqyruara rregullisht në aktet dhe njoftimet e shoqërisë, përfshirë edhe mospërcjelljen për regjistrim në QKB, me qëllim që t’iu bëhen të njohura rregullisht dhe ligjërisht të tretëve; teksa konstaton se janë ndërmarrë veprime të njëanshme nga ana e shoqërisë “Mabco Constructions SA” lidhur me ndryshimin e adresës së selisë së shoqërisë, shkarkimin e administratorit, etj.; krahas një vendimi të shoqërisë “Mabco Constructions SA” për kufizimin e çdo transferimi pronësie (të kaluar, të tashëm apo të ardhshëm) të kuotave të zotëruara prej saj në kapitalin themeltar të “Vlora International Airport – VIA” sh.p.k., deri në një vendimarrje të dytë dhe të regjistrimit të tyre në QKB (Shih më sipër); teksa ka shpërfillur kërkesat e ortakut tjetër të pakicës për mbledhje të Asamblesë dhe reflektim të ndryshimeve të raporteve të kuotave e kërkesa të tjera; teksa është paraqitur për miratim një Draft-Statut i VIA sh.p.k. që mbart parashikime mbi ndryshime thelbësore në raport me Statutin aktual lidhur me “*përcaktimin e momentit të kalimit të kuotave*” si dhe “*të drejtën e Asamblesë së Përgjithme të Ortakëve për anulimin e kuotave*” në drejtim të shumicës vendimarrëse; teksa mban në konsideratë parashitësen mbi veprimin e njëanshëm të kryer nga shoqëria “Mabco Constructions SA” për të lidhur një kontratë kredie me një subjekt huadhënës të panjohur, me objekt dhënien e një huaje në vlerën 100.000.000 euro, me qëllim realizimin/financimin e projektit të VIA, duke lënë si garanci projektin për të cilin është lidhur Kontrata Koncesionare; duke mbajtur posaçërisht parasysh edhe faktin se projekti themelor, objekt i kontratës koncesionare ndërmjet palëve, është aeroporti ndërkombëtar i Vlorës, i cili është objekt me rëndësi strategjike, duke ngërthyer kështu edhe interes publik dhe kombëtar në vetvete, në funksion edhe të mbrojtjes së interesave të kërkuesit, por edhe vetë Shoqërisë VIA sh.p.k., teksa njihet paraprakisht me faktin se, kërkuesi do të paraqesë përpara Gjykatës kërkesë-padinë e themelit me objekt “*Shfuqizimin e vendimeve të paligjshme të Shoqërisë Mabco si dhe rregullimin e pasojave të rrjedhura*”, çmon se, është e mundshme ekzistenca e të drejtës subjektive të pretenduar, krahas ekzistencës së frikës së përligjur të palës kërkuese, 2A Group sh.p.k., duke e legjitimuar në kërkimin për të pezulluar vendimarrjen në mbledhjen e planifikuar të datës 20.10.2025, deri në zgjidhjen e çështjes në themel.

Gjithashtu, në funksion të zgjidhjes përfundimtare të problematikës thelbësore që ekziston në njohjen dhe regjistrimin e kontratës së shitblerjes së kuotave, dt. 03.04.2025, ndërmjet ortakëve pjesëmarrës në shoqërinë VIA sh.p.k., do të urdhërohet pezullimi i të drejtës së votës të ortakut të shumicës, përkatësisht shoqërisë “Mabco Constructions SA”. Kjo masë merret edhe në vlerësim të faktit se, ortaku i pakicës, cilësohet aktualisht si mbajtës i vetëm 2% të

kuotave në kapitalin e shoqërisë, teksa ai mbart pretendime të bazuara mbi një kontroll të një kuote më të lartë, krahas pretendimeve të avancuara për mbrojtjen e investimit të tij efektiv në projektin e Kontratës Koncesionare.

Nëpërmjet institutit juridik procedural të sigurimit të padisë, gjykata, duke kryer një vlerësim paraprak dhe jo të thelluar të fakteve dhe provave të çështjes, arrin në përfundimin se, ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit të themelit për të drejtat e paditësit (kërkuesit) do të shkaktonte një dëm të konsiderueshëm dhe të pakthyeshëm, krahas cenimit potencial edhe të interesit publik, pasi vetë projekti lidhet me interesa të brendshme kombëtare (aeroport ndërkombëtar), duke ngërthyer interesa strategjike të vendit; për pasojë do të lejohet marrja e masës së sigurimit të padisë.

Duke disponuar si më sipër, gjykata do të caktojë një afat prej pesëmbëdhjetë ditësh, konform nenit 204/2 të K.Pr.Civile, brenda të cilit pala kërkuese duhet të paraqesë padinë e themelit në gjykatë.

Për sa më sipërargumentuar, gjykata vlerëson se kërkesa është e bazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata, bazuar në nenet 125, 202, 204, 205 e vijues të K.Pr.Civile,

-

-

VENDOSI:

-

1. Pranimin e kërkesës.
2. Marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke pezulluar marrjen e çdo vendimi në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë “Vlora International Airport – VIA” SH.P.K., të njoftuar për t’u mbajtur më datën 20.10.2025, sipas atij rendi dite, deri në vendimin përfundimtar të gjykatës, si dhe pezullimin e të drejtës së votës të ortakut të shumicës, Shoqërisë “Mabco Constructions SA” deri në regjistrimin e kontratës së shitjes së kuotave të datës 03.04.2025, me objekt transferimin e 49% të kuotave të kapitalit të shoqërisë VIA sh.p.k. tek blerësi 2A Group sh.p.k.
3. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës kërkuese.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi i veçantë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, brenda 5 ditëve, afat ky që fillon të llogaritet nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit.

U shpall në Tiranë, sot, më datë 17.10.2025.

SEKRETARE

AMANTIA ZISI

GJYQTAR

FATMIR NDREU

Shpenzime gjyqesore

Takse kerkese (parapaguar pala kerkuese) 200 leke

Njofime (parapaguar pala kerkuese) 300 leke